



Pranuar / Dorezuar Prilježen / Predato Received / Delivered	05.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STK	7677	/2022	113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.522/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.1873/2021 të datës 31.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.522/2021 të datës 09.06.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë të vendbanimit: kundër

organit të punësimit/Policia e Kosovës, në çështjen juridike "*kërkesë nga marrëdhënia e punës*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.522/2021 e datës 09.06.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Policinë e Kosovës, në vendin e punës "*Teknik i tavolinës ndihmëse*", në Departamentin e Teknologjisë Informative, sipas Kontratës së punës me numër Nr.Ref.0392 të datës 01.12.2010, më datë 18.05.2021 ka parashtruar kërkesë përmes E-mailit zyrtar, drejtuar Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës, me kërkesë për ngritje të koeficientit nga gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7), ndryshimin e pozitës prej pozitës: "*Teknik i tavolinës ndihmëse*", në pozitë: "*Specialiste e tavolinës ndihmëse*", dhe shtesën mbi pagën bazë prej 100 euro, në raport me kolegët që janë në të njëjtë pozitë .

Ankuesja kundër heshtjes administrative, me datë 09.06.2021 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 2975/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet e njëjta si në kërkesën e datës 18.05.2021, drejtuar (për mes e-mailit) Drejtorisë së Personelit në Policinë e Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses me numër të protokollit 3056/2021 të datës 14.06.2021 tek Policia e Kosovës, e cila me datës 02.07.2021 e ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 3415/2021, me shkresat e bashkangjitura të lëndës, prej 1/20 faqe.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për të vendosur, me datë 22.07.2021 e ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së saj dhe e ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesja, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe mbi këtë bazë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 30.10.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1873/2022 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e datës 09.06.2021 të parashtruar nga ankuesja.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:* Aktgjykimit A.nr.1873/2021 të datës 31.10.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 22.07.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën me numër të protokollit 2975/2021 e regjistruar me numër A.nr. 522/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-mail i datës 18.05.2022 lidhur me kërkesën e drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore në Policinë e Kosovës; Diplomë Universitare Nr. 626 e datës 20.09.2004, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Shkolla e Lartë Pedagogjike dhe merr kualifikimin-Arsimtar i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe; Diplomë Universitare Nr.2154 e datës 27.05.2015, lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Edukimit në programin Teknologji-Informatike dhe merr titullin "Bachelor i Teknologjisë - Informatikës"; Certifikatë e ankueses Microsoft për përsosmëri; Certifikatë e datës 29.09.2014 Microsoft për Arritje; Certifikatë e datës 02.07.2014 Microsoft për Arritje; Certifikatë e lëshuar me datës 29.09.2008 nga Microsoft për Arritje; Certifikatë e datës 17.10.2008 nga Microsoft për Arritje; Certifikatë e datës 06.11.2008 nga Microsoft për Arritje; Certifikatë e datës 21.11.2008 nga Microsoft për Arritje; Certifikatë e datës 12.12.2008 nga Microsoft për Arritje; Përgjigje në ankesë e datës 02.07.2021, Kontratë e punës Nr. Ref.0392 e ankueses të datës 01.12.2010; Përshkrim i detyrave të punës; kopje nga shpallja e konkursit të datës 28.11.2005; E-mail i datës 18.02.2021, i datës 09.02.2021, i datës 11.01.2021, bashkangjitur lista e statutit të zyrtarit publik gjegjësisht ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses  
*është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se:  
1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, dhe rrjedhimisht*

duke marr parasysh konstatimin si më lartë se ankuesja me datë 18.05.2021 përmes emalit zyrtar ka parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës me pretendimet për ngritjen e koeficientit nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin shtatë (7), për ndryshimin e pozitës prej pozitës: "Teknik i tavolinës ndihmëse", në pozitë: "Specialiste e tavolinës ndihmëse", si dhe për shtesën mbi pagën bazë prej 100 euro, në raport me kolegët që janë në të njëjtë pozitë, mirëpo nuk ka marr përgjigje, ndërsa me datë 09.06.2021 ankuesja kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshill ende pa kaluar afati i përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative - heshtja administrative, kështu që ankesa e ankueses është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe neni 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA A.NR.522/2021**

Zyle Millaku GOJNOVCI

  
Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

